



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr.192, datë 09.04.2024

**PËR
KUALIFIKIMIN E KANDIDATES {...}
DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE NË
GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË, PËR POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE DHE
PENALE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR.79, NR. 80 DHE NR. 81 DATË
20.02.2024, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 09.04.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kriterëve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr.79, nr. 80 dhe nr. 81 datë 20.02.2024, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr.73- nr.86 datë 20.02.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur hapjen e katërmbëdhjetë procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimet nr. 73-81 datë 20.02.2024 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shtatë

pozicione të lirë në fushën e të drejtës civile dhe për dy pozicione të lirë në fushën e të drejtës penale. Me vendimet nr. 82-86 datë 20.02.2024 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për tre pozicione të lirë në fushën e të drejtës civile dhe për dy pozicione të lirë në fushën e të drejtës penale.

2. Në këto procedura të lëvizjes paralele, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurës është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 20.02.2024, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 01.03.2024.

3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionet e lira nr.79, nr. 80 dhe nr. 81 datë 20.02.2024 kandidon edhe znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja) gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

4. Mbas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit 79/2024, 80/2024 dhe 81/2024, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.127, datë 11.03.2024, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj. {...}.

5. Me Vendimin nr. 140, datë 13.03.2024, *“Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86 datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”*, Këshilli ka vendosur:

“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82,83 dhe 85, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2(dy) vlerësime.

II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ... 2. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro; ...”.

6. Më datë 18.03.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, *“Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”* (më poshtë referuar si vendimi 320/2020), në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e

relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

7. Brenda afatit të përcaktuar, kandidatja nuk parashtrori ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

8. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu V, të vendimit 320/2020, përmes shkresave të veçanta, për kandidaten znj. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykata ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares.

9. Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale specifike” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me anë të komunikimit elektronik datë 19.03.2024, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

10. Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale specifike” të kandidates në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës civile dhe penale, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, informacioni u kërkua në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, informacioni i kërkuar është përcjell me anë të postës elektronike datë 27.03.2024 siç do të përshkruhet më poshtë, informacioni u kërkua në Gjykatën së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, informacioni i kërkuar është përcjell me anë të postës elektronike datë 27.03.2024 siç do të përshkruhet më poshtë.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KRITEREVE TË KANDIDIMIT

11. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “Përvojës profesionale specifike minimale”

12. “Përvoja profesionale specifike minimale” për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, në rastin konkret në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimeve nr.79, nr. 80 dhe nr. 81 datë 20.02.2024, është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”.

13. Për verifikimin e kandidates në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për lëvizjen paralele u mbajti parasysh se ajo ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile dhe penale të shpallura me vendimin nr.79, nr. 80 dhe nr. 81 datë 20.02.2024, çka do të thotë se kandidatja duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile dhe penale gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit.

14. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2008, ndërkohë ajo është emëruar për të kryer stazhin profesional si gjyqtarë” pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për periudhën tetor 2007 deri mars 2009, ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme, çështje civile si dhe çështje penale. Në vijim, ajo është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, detyrë të cilën e ka ushtruar për periudhën deri më mars 2021 pasi me vendimet e caktimit dhe ri caktimit nga ane e Këshillit ajo caktohet/ ri caktohet për të gjykuar si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Korçë për një periudhë mars 2021 deri shkurt 2023 duke filluar nga data 01.02.2023 dhe rikthehet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në datë 16.12.2021 zgjidhet Zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Me vendim nr. 134, datë 28.03.2023“Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”, nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, ku dhe aktualisht ushtron funksionin, ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme, çështje civile si dhe çështje penale.

15. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 30.06.2005 dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2008. Me dekret nr. 5475, datë 05.10.2007 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare dhe caktohet të kryej stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Me dekret nr. 6106, datë 25.03.2009 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Me vendim nr. 105, datë 25.03.2021 të Këshillit të Larë Gjyqësor caktohet për të gjykuar si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një periudhë deri në 25.03.2022. Me vendim nr. 113, datë 28.03.2022 të Këshillit të Larë Gjyqësor ri caktohet për të gjykuar si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një periudhë deri në 25.03.2023. Me vendim nr. 46, datë 27.01.2023 të Këshillit të Larë Gjyqësor deklarohet përfundimi para afatit të shërbimit në skemën e delegimit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, duke filluar nga data 01.02.2023 dhe rikthehet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Me vendim nr. 134, datë 28.03.2023“Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”, nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të

Përgjithshëm Korçë. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 16 vite. Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

16. Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, nga verifikimet e kryera, rezulton se :“znj. {...}, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe ka filluar punë në datë 18.10.2007. Gjatë periudhës që ka ushtruar funksionin e gjyqtares në shkallë të parë ka qenë pjesë e seksionit penal në periudhat 25.03.2009 - 18.01.2011, 23.01.2012 deri 12.01.2015, 21.01.2018 deri ne 18.03.2019. Për periudhën nga data 18.03.2019 e në vijim Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë nuk ka funksionuar e ndarë në seksione (seksion civil/seksion penal), por ka qenë e ndarë në trupa gjykues për gjykimin e çështjeve civile/penale. Gjyqtare {...} ka gjykuar të gjithë natyrën e çështjeve gjyqësore. Me vendimin nr. 161 Prot datë 24.12.2020 të këshillit të gjykatës “Mbi shpërndarjen e gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues”, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, ka funksionuar si seksion vetëm seksioni penal për të mitur , gjyqtarët e të cilit do të gjykojnë çështjet penale me të pandehur të mitur dhe viktima të mitur, pjesë e këtij seksioni është dhe gjyqtare {...}”.

16.1 Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nga verifikimet e kryera, rezulton se: “Në përgjigje të kërkesës për informacion dhe dokumentacion, ju bëjmë me dije se gjyqtare {...} ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Apelit Korçë për periudhën 25.03.2021-01.03.2023 dhe gjatë kësaj periudhe kjo gjyqtare ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve (civile, kërkesa civile, penale, kërkesa penale etj.), pasi gjyqtaret e kësaj gjykate nuk ishin të ndarë në dhoma apo seksione”.

17. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallura me Vendimet e Këshillit nr.79, nr. 80 dhe nr. 81 datë 20.02.2024, ka mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile dhe penale gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.

18. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

19. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter ndalues për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, që gjen reflektim në shkronjën “b”, të pikës 5, të vendimeve nr.79, nr. 80 dhe nr. 81 datë 20.02.2024, është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë nëse ka në fuqi një masë disiplinore.”

20. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 28.02.2024, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.

21. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

22. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

23. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

24. “Papajtueshmëria ambientale” si kriter ndalues për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të vendimeve nr.79, nr. 80 dhe nr. 81 datë 20.02.2024, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Këshillat, gjatë ... transferimit, ..., për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, efienca e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: “Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me lëvizjen paralele, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: “Papajtueshmëria ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”.

25. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 28.02.2024, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

26. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

27. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidaten Këshilli vlerëson se znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke plotësuar kështu kriterin e “*papajtueshmërisë ambientale*”.

III. KONKLUSIONE

28. Referuar kërkesave të Vendimit 320/2020, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimeve nr.79, nr. 80 dhe nr. 81 datë 20.02.2024, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit të znj. {...} për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

29. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit për kandidaten znj. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të tre kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallua me vendimet nr.79, nr.80 dhe nr.81 datë 20.02.2024.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 8 dhe në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, si dhe në pikën 10, të vendimit të tij nr. 79, datë 20.02.2024, “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”; nr. 80 datë 20.02.2024, “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”; nr. 81, datë 20.02.2024, “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallura me vendimet nr.79, nr. 80 dhe nr. 81 datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR